

VENDIM
Nr. 7, datë 18.12.2019

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË ADMINISTRIMIT DHE SHPËRNDARJES SË MALLRAVE, NDIHMË HUMANITARE, DHURUAR NGA DONATORË TË HUAJ ME DESTINACION TË PËRCAKTUAR TË NJË KOMUNITETI

Në mbështetje të nenit 19, të ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, të pikës 4, të nenit 10, të ligjit nr. 9900, datë 10.4.2008, “Për rezervat materiale të shtetit”, të ndryshuar, të ligjit nr. 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të vendimit nr. 750, datë 27.11.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Lezhë dhe Tiranë”, të ndryshuar, Komiteti Ndërmintor i Emergjencave Civile, i mbledhur sot më 18.12.2019

VENDOSI:

1. Përcaktimin e rregullave dhe procedurave për administrimin dhe shpërndarjen e mallrave, ndihmë humanitare, që vijnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në rastet kur donatori ka përcaktuar shprehimisht një komunitet të caktuar si pritës të këtyre mallrave.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe strukturat lokale të mbrojtjes civile për qarqet e Durrësit, Tiranës dhe Lezhës të bashkërendojnë punën për kryerjen e procedurave doganore, pritjen e mallrave dhe lëvrimin e tyre, drejtpërdrejt nga këta të fundit, në favor të komunitetit të përcaktuar nga donatori.

3. Në rast se strukturat lokale njoftohen paraprakisht nga donatori për dërgesën, pikën kufitare hyrëse dhe kohën e parashikuar të mbërritjes së mallrave me destinacion të përcaktuar, atëherë ato autorizojnë një përfaqësues, i cili paraqitet në degën doganore përkatëse për të bërë të mundur kryerjen e procedurave dhe shoqërimin e mallrave deri në destinacionin e përcaktuar.

4. Në rast se strukturat lokale nuk kanë dijeni paraprake për një dërgesë të caktuar, atëherë, menjëherë me mbërritjen e mallrave, ndihmë humanitare, në pikën kufitare, degët doganore të njoftojnë pa vonesë strukturat lokale, të cilat vijojnë të procedojnë normalisht, sipas mënyrës së parashikuar në pikën 3, të këtij vendimi.

5. Për garantimin e zbatimit të procedurave të këtij vendimi, çdo strukturë lokale të vërë në dispozicion të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, së paku dy pika kontakti me qëllim koordinimin e menjëhershëm të punës.

6. Kur vlerësohet e arsyeshme, për shkak të natyrës apo vlerës së dërgesës, strukturat lokale mund të bashkëpunojnë me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit ose Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, me qëllim shoqërimin e mallrave të dhuruara nga pika kufitare deri në mbërritjen në destinacion të e përcaktuar nga donatori. Në rast se dërgesa vjen në rrugë tokësore dhe gjatë rrugës për në destinacion ndryshon njësia e ngarkuar për shoqërimin e mjeteve, atëherë përpilohet procesverbal për çdo dorëzim detyrë, nga njëra njësi në tjetrën. Ky procesverbal bëhet pjesë e praktikës shkresore përfundimtare.

7. Në përfundim të lëvrimin të mallrave, në favor të komunitetit pritës, përfaqësuesi/komisioni i ngarkuar nga strukturat lokale për të pritur dhe lëvruar mallrat harton një procesverbal ku të shënohen, sipas rastit, të dhënat e donatorit, dërgesës, lista e mallrave dhe pritësi i mallit. Procesverbali të mbahet në tri kopje, nga të cilat një kopje të qëndrojnë në strukturën lokale, një të vihet në dispozicion të donatorit dhe një t'i përcillet menjëherë degës doganore në të cilën janë kryer procedurat, sipas pikave 3 dhe 4, të këtij vendimi.

8. Për rastet para hyrjes në fuqi të këtij vendimi, të pritjes dhe lëvrimin, nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit, të mallrave, ndihmë humanitare, me destinacion të përcaktuar nga donatori, të përfundohen procedurat e lëvrimin me marrjen e konfirmimit nga

komuniteti përfitues. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit, që brenda një muaji nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të përcjellë pranë KNEC-së një relacion të detajuar për ndihmat humanitare me destinacion të përcaktuar, të lëvruara deri tani.

9. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, strukturat lokale të mbrojtjes civile për qarqet e Durrësit, Tiranës dhe Lezhës, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I KOMITETIT NDËRMINISTROR
TË EMERGJENCAVE CIVILE
KRYEMINISTËR
Edi Rama